



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:236509
Datë: 22.10.2024
Numri i dokumentit: 06334503

Kom.Dh.Shk.II.nr.1846/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Saranda Bogaj – Sheremeti, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike - konfliktin administrativ sipas paditësit N.T “Sporting” (F.G. B.I) me seli ne Prizren dhe Albos Shpk me seli ne Suhareke te cilët i përfaqëson Visar Ostrozubi avokat ne Prizren, kundër kundërshtareve te propozimit - të paditurve Organi Shqyrtues i Prokurorit Publik me seli ne Prishtine dhe Ministria e Arsimit Shkences, Teknologjis dhe Inovacionit me seli ne Prishtinë, me bazë juridike për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, nr. 208, datë 20.08.2024, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit - propozuesit kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti Administrativ KA.nr.421/24, të datës 02.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e propozuesve – paditësve N.T “Sporting” (F.G. B.I) me seli ne Prizren dhe Albos Shpk me seli ne Suhareke, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosoves - Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti Administrativ KA.nr.421/24, të datës 02.09.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti Administrativ KA.nr.421/24, të datës 02.09.2024, është hudhe poshtë kërkesa e paditëseve, për shtyrjen e ekzekutimit të kontratës se prokuroririt publik “Furnizimi me rekuizita sportive per sallat e edukatës fizike ne Shkollat e Arsimit Parauniversitar ne Kosovë” me numër protokolli 208, udhëheqësi 24-204-1-1-1 te nënshkruar me date 20.08.2024.

Kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së parë, pala paditëse, përmes te autorizuarit ka ushtruar ankesa ndaj vendimit te shkalles se parë, për shkak të shkeljes

së dispozitave të procedurës, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktvendimin e kontestuar ta ndryshon dhe të aprovojë kërkesën në tërësi për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së propozuesit -te paditësit, kolegji i kësaj gjykate, gjen se Dhomat e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të kontratës së prokurimit publik "Furnizimi me rekuizita sportive për sallat e edukatës fizike në Shkollat e Arsimit Para universitar në Kosovë" me numër protokollit 208, udhëheqësi 24-204-1-1-1 të nënshkruar me datë 20.08.2024, ka gjetur se propozimi i tillë është i palejueshëm, ngase paditësi nuk e ka kërkuar shtyrjen e ndonjë akti administrativ perfundimtar, por të një kontratës së lidhur pasi ka perfunduar një aktiviteti i prokurimit derisa sipas nenit 13 para. 1 të LKA-se "Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të xjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë", ndërsa në para. 2 së të njëjtin nen percaktohet se "Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar". Objektin e konfliktit administrative ka regulluar edhe neni 14 i LKA-se, sipas të cilit "Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerre akt perkates administrativ sipas kërkeses ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj."

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm një konkludim të tillë të gjykatës së shkallës së parë ngase edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par. 6 lidhur me par. 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, pasi që në kuptim të nenit 13 para. 1 të LKA-se "Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të xjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë", ndërsa në para. 2 së të njëjtin nen percaktohet se "Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar". Objektin e konfliktit administrative ka regulluar edhe neni 14 i LKA-se, sipas të cilit "Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerre akt perkates administrativ sipas kërkeses ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj.", derisa në siç rezulton nga pretendimet në padi, në propozim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit dhe nga shkresat e lëndës, në rastin konkret pala paditese ka inicuar propozim për shtyrjen e ekzekutimit të kontratës së prokurimit publik "Furnizimi me rekuizita sportive për sallat e edukatës fizike në Shkollat e Arsimit Para universitar në Kosovë" me numër protokollit 208, udhëheqësi 24-204-1-1-1 të nënshkruar me datë 20.08.2024, e që në rastin konkret nuk mund të jete objekt i shqyrtimit në konfliktin administrativ.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të propozueses- paditëses, në ankesë të cekura më lartë ndaj aktvendimit të shkallës së parë se me ekzekutimin e vendimit të atakuar do të i shkaktohet dëm i pariparueshëm propozuesit, kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të vërtetuara, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe vlerësimi i kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit siç parashihet në nenin 6 dhe 22 par.2 të LKA-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji gjen se Gjykata Komerçiale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Administrativ në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit me rastin e hudhjes se propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit dhe se pretendimet ankimore janë të pa ndikim për vendosje në mënyrë tjetër, andaj ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1846/2024, me datë 21.10.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Faton Bajrami, d.v